

VENDIM
Nr. 219, datë 20.2.2013

PËR KALIMIN E DISA PRONAVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronat sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’i tjetërsojë ato ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha